



Technical Assistance for Strengthening the Capacity of the Ministry of Environment, Forests and Water Administration in Albania for Law Drafting and Enforcement of National Environmental Legislation

PROJEKT-VENDIM

“MBI GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE NË BURIM”

Draft 1

Version 3

24 Tetor 2012



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____

“MBI GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE NË BURIM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozim të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i afateve dhe objektivave për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:
 - a) Optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
 - b) Sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
 - c) Promovimit të ripërdorimit të produkteve;
 - d) Përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
 - e) Lehtësimit dhe/ose përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

II. OBJEKTI

2. Ky vendim do të zbatohet për këto rryma mbetjesh:

- a) Letër/Karton;
- b) Metal;
- c) Plastikë;
- d) Qelq;
- e) Tekstile.

III. PËRKUFIZIME

3. Termat e përkufizuar në nenin 3, të Ligjit nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a) “Mbetje të riciklueshme të thata” është një grup mbetjesh që përfshin rrymat e mbetjeve të letrës/kartonit, disa lloje plastikash, qelq, konteinerët e lëngjeve dhe kanaçet e aluminit që mund të përpunohen dhe riprodhohen si produkte të reja dhe materiale të tjera;
 - b) “Mbetje të pariciklueshme” është një grup mbetjesh që përfshin rrymat e mbetjeve të letrës/kartonit të ndotur, qese plastike të holla, pelena, mbetje spitalore, qese me vakum ose materiale të tjera që nuk janë praktikisht të riciklueshme brenda njësie përkatëse të qeverisjes vendore;
 - c) “Mbetje të riciklueshme të njoma” është një grup mbetjesh që përfshin rrymat e mbetjeve nga shtëpitë përfshirë ato të frutave dhe perimeve të pagatuara, lule të prera, letër dhe karton të lagura. Në të përfshihen edhe mbetjet e biodegradueshme që përbëhen nga mbetjet e kopshteve, si bar ose kërcëj lulësh, bimë dhe degë pemësh, mbetje nga krasitjet, etj;
 - d) “Njësi e Qeverisjes Vendore” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;
 - e) “Ministër” është Ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit;
 - f) “Ministria” është Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit;
 - g) “Agjensia Kombëtare e Mjedisit (AKM) – ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

IV. AFATET DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË RRYMAVE TË MBETJEVE

4. Bashkitë e kategorisë së parë, sipas përcaktimit në nenin 3, të ligjit nr.10258, datë 25.3.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” (Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Pogradeci, Korça, Lezha, Lushnja, Kukësi, Peshkopia, Laçi, Kamza dhe Kavaja) përcaktojnë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve brenda 30 Qershor 2016, të paktën për rrymat e mbetjeve të mëposhtme:

- a) Letër/karton;
 - b) Metal;
 - c) Plastikë;
 - d) Qelq;
 - e) Tekstile.
5. Njësitë e Qeverisjes Vendore, të tjera nga ato të kategorisë së parë, duhet të marrin masa të përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve brenda 31 Dhjetorit 2018, të paktën për rrymat e mbetjeve të përcaktuara në paragrafin 4.
 6. Masat e referuara në paragrafin 4 dhe 5 duhet të përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në Aneksin I.
 7. Objektivi për t'u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore brenda 31 Dhjetorit 2023 për përgatitjen, për ripërdorimin dhe riciklimin e materialeve të mbetjeve (mbetjeve shtëpiake), të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin nga shtëpitë dhe mundësisht prej origjine tjetër, - për aq sa këto rryma mbetje janë të ngjashme me mbetjet shtëpiake – duhet të arrijnë minimumi në 50% të peshës së përgjithshme mbështetur në gjenerimin e mbetjeve në 2010 dhe prodhimin në nivel kombëtar.
 8. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të marrin masat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim dhe t'i sigurojnë qytetarëve minimalisht një sistem mbetjesh prej tre grupesh për mbetjet shtëpiake:
 - a) Mbetje të riciklueshme të thata;
 - b) Mbetje të riciklueshme të njoma;
 - c) Mbetje të pariciklueshme.

Në disa raste, kur justifikohet nga kufizimet ekonomike, njësitë e qeverisjes vendore mund të fillojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve duke përdorur sistemin e mbetjeve prej dy grupesh me një progres të planifikuar në drejtim të sistemit të mbetjeve prej tre grupesh. Ministri, rast pas rasti do të vlerësojë planin e menaxhimit të mbetjeve të njësisë së qeverisjes vendore dhe do të vendosë, në qoftë se kalimi nga dy grupe në tre grupe sistemi mbetjesh është i pranueshëm ose jo.

V. OBJEKTIVAT PËR RIPËRDORIMIN DHE RICIKLIMIN E RRYMAVE TË MBETJEVE

9. Objektivat specifik për ripërdorimin dhe riciklimin sipas peshës, duhet të jetë si më poshtë:
 - a) letër/karton (60%);
 - b) metal (50%);
 - c) plastikë (22.5%);
 - d) qelq (60%);
 - e) tekstile (15%).

10. Objektivat e ndërmjetëm duhet të parashikohen nga njësitë e qeverisjes vendore në planet e tyre të menaxhimit në përputhje me nevojat lokale dhe mundësitë aktuale. Objektivat e përcaktuar në paragrafin 9 të këtij seksioni janë të detyrueshme për t'u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore të çdo niveli.
11. Planet bashkiake të menaxhimit të mbetjeve të përgatitura nga njësitë e qeverisjes vendore duhet të parashikojnë masa dhe metoda për arritjen e objektivave brenda afateve të vendosura dhe duhet të hartohen në përputhje me Udhëzuesin “Për Planifikimin e Menaxhimit Lokal të Mbetjeve” të miratuar nga Ministri.

VI. BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETEVE

12. Me qëllim arritjen e objektivave të parashikuar në paragrafin 1, njësitë e qeverisjes vendore duhet të bashkëpunojnë në kuadër të rrejtit të integruar, të instalimeve, në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Ky bashkëpunim duhet të bëjë të mundur grumbullimin maksimal të mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin ose depozitimin në një prej instalimeve më të afërt, të përshtatshme, me metodat dhe teknologjitë më të përshtatshme, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mjedisor dhe mbrojtje të shëndetit publik.

VII. TARIFA E MBETJEVE

13. Tarifat e mbetjeve që duhen paguar nga prodhuesit e mbetjeve përcaktohen nga njësitë e qeverisjes vendore. Tarifa duhet të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi në pikën e fundit të depozitimit të paguar nga njësitë e qeverisjes vendore. Sistemi tarifor duhet të jetë i tillë që ndërsa vendos nxitësa ekonomike që inkurajojnë ndarjen e mbetjeve në burim, të mos nxisë shkarkimin e paligjshëm të tyre.

VIII. RAPORTIMI MBI ZBATIMIN E KËTJË VENDIMI

14. Çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të raportojë të dhënat mbi grumbullimin e rrymave të mbetjeve dhe objektivat në Agjensinë Kombëtare të Mjedisit brenda datës 31 Janar të çdo viti.
15. Agjensia Kombëtare e Mjedisit përpunon të dhënat në nivel kombëtar mbi sasinë totale të mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar dhe objektivat e arritura, i regjistron ato në regjistrin e krijuar për këtë qëllim dhe ja transmeton Ministrisë brenda 28 Shkurtit të çdo viti.
16. Agjensia Kombëtare e Mjedisit duhet të përfshijë rezultatet e gjendjes së grumbullimit të rrymave të mbetjeve në raportet mjedisore.
17. Ministria mbështetur në të dhënat e Agjensisë Kombëtare të Mjedisit harton raportin mbi zbatimin e këtij Vendimi, si pjesë integrale të raportit mbi zbatimin e ligjit nr.10463, datë

22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të parashikuar në nenin 66, paragrafi 1, brenda 30 Tetorit 20XX dhe më pas çdo tre vjet.

18. Formati që do të përdoret për përcaktimin e kërkesave për llogaritjen e objektivave dhe hartimin e raportit, të parashikuar në paragrafin 17, së bashku me informacionin që duhet përfshirë në të përcaktohet me Urdhër Ministri. Raporti referuar në paragrafin 17, duhet të plotësojë kërkesat minimale të përcaktuara në Aneksin II.
19. Agjensia Kombëtare e Mjedisit, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përkatëse duhet t'i sigurojnë Ministrisë çdo informacion tjetër përkatës për përgatitjen e raportit të parashikuar në paragrafin 17.

IX. INFORMACION TJETËR

20. Raporti referuar në paragrafin 17 publikohet në faqen elektronike zyrtare të Ministrisë dhe bëhet i disponueshëm për publikun.

X. AUTORITETET KOMPETENTE PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI

21. Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për arritjen e objektivave dhe afateve të përcaktuara në këtë vendim.
22. Agjensia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të parashikuara në këtë vendim.
23. Ministria është përgjegjëse për mbikqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

XI. SANKSIONET

24. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas nenit 62, të Ligjit nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

XII. ANEKSET

25. Anekset bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij.

XIII. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
SALI BERISHA**

**ANEKSI I: Kërkesat minimale për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve
(Referuar paragrafit 6 të Seksionit IV të këtij Vendimi)**

1. Përcaktimi i kufijve administrative të zonave të shërbimit të mbetjeve dhe të zonave përgjegjëse, duke përcaktuar qartë kush është përgjegjës për dispozitat e shërbimit të mbetjeve;
2. Përcaktimi i zonave kufi midis njësive lokale, kur lindin pasiguri dhe konflikte për shkak të disa Njësive të Qeverisjes Vendore, të cilat nuk ofrojnë ndonjë shërbim për mbetjet;
3. Informacion mbi prodhuesit e mbetjeve duke siguruar të dhëna të vlefshme se cila Njësi e Qeverisjes Vendore do t'i shërbejë atyre;
4. Vlerësimi i volumit dhe specifikimit të llojit të mbetjeve që do të menaxhohen (informacioni përfshin të dhënat aktuale dhe të dhënat e mëparshme – për një periudhë 5 - 8 vjet – në lidhje me popullsinë brenda zonës së tyre të përgjegjësisë, karakteristikat e tyre, numrin dhe madhësinë mesatare të familjeve, llojin dhe madhësinë e njësive të biznesit; industritë dhe institucionet - numrin e ndërtesave të bashkisë, edukimin, ndërtesat sociale ose të kulturës; njësitë mjekësore ose shëndetësore brenda zonës së mbetjeve);
5. Informacioni shtesë mund të përfshijë zhvillimin e mëtejshëm të të dhënave mbi familjet dhe bizneset në qytet duke specifikuar llojin e qëndrimit (banorë të përhershëm ose banorë të përkohshëm), si dhe informacioni që mbulon banorët që jetojnë ilegalisht në zonat praën kufijve të qytetit;
6. Përcaktimi i skemës së grumbullimit të mbetjeve dhe transportit në lidhje me aktivitetet vendore në kuptim të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve; kjo shpesh mund të përfshijë ose të shoqërojë aktivitete të tjera të tilla si: ndarjen e mbetjeve, përpunimin, transferimin, etj.

Analiza dhe vlerësimi i situatës aktuale dhe/ose vendimi për përmirësimin e skemës ekzistuese ose të planit për të filluar një shërbim të ri duhet të përfshijë:

- a) Pikat e grumbullimit të mbetjeve do të përmbajnë një ose më shumë kontenierë (zakonisht sistemin me tre kosha);
- b) Frekuencën e Grumbullimit të Mbetjeve;
- c) Kamionët dhe Kontenierët e Mbetjeve;
- d) Përmirësimi i rrugëve të kamionëve;

Përzgjedhja e llojit të përshtatshëm të kontenierit në përputhje me sistemin e mbetjeve minimalisht prej tre koshash të përcaktuar në Paragrafin 8 të këtij vendimi.

ANEKSI II: Kërkesat minimale për raportimin

(Referuar paragrafit 14 të Seksionit VIII të këtij Vendimi)

Në nivel kombëtar:

1. Përshkrimi i metodave të grumbullimit të mbetjeve;
2. Përshkrimi i metodave të regjistrimit të sasive të rrymave të mbetjeve;
3. Të dhënat e mbledhura dhe informacioni sic është përshkruar në pikën 5 deri në 10 të këtij Aneksi;
4. Vlerësimi i përgjithshëm mbi objektivat e arritur të rrymave të mbetjeve.

Në nivelin e qeverisjes vendore:

5. Të dhënat për mbetjet e gjeneruara sipas çdo rryme në periudhën e raportimit;
6. Pesha e përgjithshme për çdo rrymë mbetje të grumbulluar në mënyrë të diferencuar;
7. Pesha e përgjithshme për çdo rrymë mbetje nga lloji i materialeve përbërëse;
8. Lloji i mbetjeve të grumbulluara;
9. Si janë grumbulluar mbetjet;
10. Kush i ka grumbulluar mbetjet;
11. Sa shpesh janë grumbulluar mbetjet;
12. Identifikimi i kontraktorëve të përfshirë në grumbullimin e mbetjeve;
13. Destinacioni i mbetjeve;
14. Sasia e mbetjeve të trajtuara/përpunuara dhe lidhja/marrëdhënia me sasinë e grumbulluar.